



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MAJTUR MË
12 MARS 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 12. MARTA 2008.
GODINE

Mars – Mart
2008

R e n d i i d i t ë s:

Shqyrtimi i parë i grupit të dytë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtisarit:

1. Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
2. Projektligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
3. Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
4. Projektligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës,
5. Projektligji për të drejtat komuniteteve dhe pjesëtarët e tyre,
6. Projektligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i vitit 2008,
7. Projektligji për financat e Pushtetit Lokal,
8. Projektligji për Aviacionin Civil,
9. Projektligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
10. Projektligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

D n e v n i r e d:

Prvo razmatranje druge grupe nacрта zakona iz Predloga Marti Ahtisarija:

1. Nacrt zakona o Ministarstvu spoljnih poslova i diplomatskoj službi Republike Kosova,
2. Nacrt zakona o Ministarstvu Odbrambenih snaga Kosova,
3. Nacrt zakona o Bezbedonosnim snagama Kosova,
4. Nacrt zakona o osnivanju Bezbedonosnog saveta Kosova,
5. Nacrt zakona o pravima zajednica i njenih pripadnika,
6. Nacrt zakona o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima iz 2008. godine,
7. Nacrt zakona o finansijama lokalne vlasti,
8. Nacrt zakona o civilnoj avijaciji,
9. Nacrt zakona o Specijalnom tužilaštvu Republike Kosova, i
10. Nacrt zakona o nadležnostima, selekciji i određivanju predmeta sudija i tužilaca EULEX-a na Kosovu.

A g e n d a:

First reading of the Draft Laws from the Marti Ahtisaari's proposal:

1. Draft Law on Ministry of Foreign Affairs and Diplomatic Service of Republic of Kosovo,
2. Draft Law on the Ministry of Security Forces of Kosovo,
3. Draft Law on Security Forces of Kosovo,
4. Draft Law on establishing the Security Council of Kosovo,
5. Draft Law on the Rights of Communities and their members,
6. Draft Law on Managing Public Finances and Responsibilities for year 2008,
7. Draft Law on Finances of Local Government,
8. Draft Law on Civil Aviation,
9. Draft Law on Special Prosecution of Republic of Kosovo, and
10. Draft Law on competencies, selection and appointment of the files to the judges and EULEX prosecutors in Kosovo.

Seanca filloi punën në orën 14,00.

Seancën e kryesoi Jakup KRASNIQI, Kryetari i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Mirë se keni ardhur në Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.
Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 87 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2008, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, së bashku me materialet, iu janë shpërndarë deputetëve.

Për shqyrtim dhe miratim, në parim, të projektligjeve nga grupi i dytë i Propozimit të Presidentit Marti Ahtisari, propozoj që të procedohet me sa vijon:

Prezantimi nga Qeveria dhe deklarimi i grupeve kuvendore për miratimin, në parim, një nga një të projektligjeve.

Do të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Pikë e parë e rendit të ditës është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim - konform Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008.

Ftoj Kryeministrin e Kosovës që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë këtë projektligj.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari, zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë,
Me qëllim të rregullimit me ligj të autoritetit dhe të kompetencave të institucioneve të Kosovës së pavarur për ushtrimin e marrëdhënieve me shtetet dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare dhe me qëllim të promovimit të interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, ndërkombtarisht të mbrojtjes së drejtave të qytetarëve të Kosovës jashtë shtetit, si dhe të zhvillimit të raporteve me shtetet tjera, sot para jush, për aprovim paraqes

Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj, i është rikthyer Qeverisë, me qëllim të plotësimit të tij në pajtim me dispozitat e Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës, dispozita këto që rregullojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e Qeverisë dhe të Presidentit të Republikës së Kosovës në zbatimin e politikës së jashtme.

Ky projektligj është i domosdoshëm për rregullimin e kësaj sfere, sepse rregullon themelimin e një institucioni të ri, në kuadër të Qeverisë: Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj konsiderohet si një ndër projektligjet prioritarë që duhet të kalojë gjatë kësaj periudhe të realitetit të ri, si pjesë e themelimit të institucioneve të reja e të plota të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj, po ashtu, përcakton krijimin dhe organizimin e Shërbimit Diplomatik të përbërë nga anëtarët e përhershëm të Ministrisë, si dhe anëtarët e ministrisë së caktuar në misione diplomatike në vende të tjera dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

Autoritetin ekzekutiv mbi Ministrinë e Punëve të Jashtme do ta ketë ministri i Punëve të Jashtme.

Ky projektligj, është në harmoni të plotë me dispozitat e Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës dhe plotësisht respekton parimet e përgjithshme të njohura ndërkombëtarisht si dhe të përcaktuara në kuadër të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike dhe të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore.

Në fund, të nderuar deputetë, kam nderin që pata rastin të prezantoj, në pika të shkurtra, përmbajtjen e këtij projektligji kaq të rëndësishëm për vendin tonë, për institucionet shtetërore të vendit tonë dhe ju propozoj aprovimin pozitiv të tij. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër! Radhën për fjalë e kanë shefat e grupeve parlamentare, nëse ata donë.

Fillojmë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,
I nderuar zoti Kryeministër dhe kabinet qeveritar,
Të respektuar kolegë deputetë,
Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës e dimë se është kthyer njëherë dhe me aq sa kemi pasur kohë dhe mundësi ta përpunojmë si Grup Parlamentar, vlerësojmë se janë bërë përparime të dukshme dhe natyrisht si Grup Parlamentar e mbështesim.

Me këtë rast, apelojmë që të kihet kujdes, sepse nga përkthimi në përkthim, kur krahason tri gjuhët e ligjeve, del se ka edhe gabime gjuhësore, dhe jo vetëm gjuhësore, por edhe logjike herë-herë. Andaj, të kihet kujdes gjithsesi që të bëhet ky harmonizim dhe të bëhet shpjegimi adekuat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni! E ka fjalën deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar dhe, me lejen tuaj, do ta përshëndesja Kryeministrin e Kosovës, zëvendëskryeministrat dhe ministrat këtu.

Meqë ma dhatë fjalën, njëkohësisht unë deklaroj se më dhatë mundësinë që të shpreh kënaqësinë të rikonfirmoj pajtimin e Grupit tonë për projektligjet që vijnë nga Pakoja e Ahtisarit. Në qoftë se ka nevojë, ne, veç e veç edhe do të flasim për to, por ky tash për tash, është qëndrimi ynë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka përfaqësuesi i AKR-së, kryetari i Grupit Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra, të nderuar kolegë, Në pjesën e dytë të ligjeve, që burojnë nga pakoja e Ahtisarit, si Grup Parlamentar i AKR-së, duke vlerësuar lartë rëndësinë e nxjerrjes së këtyre ligjeve, në parim i mbështet për t'u proceduar më tutje në Komisionin ad-hoc dhe për t'u përmirësuar ato gabime që tashmë i vunë në spikamë edhe dy parafolësit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka përfaqësuesi i AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e mbështet edhe Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, por edhe ligjet etjera të cilat i kemi marrë si tërësi sot. Ne, definitivisht, do ta japim kontributin tonë në Komisionin ad-hoc për filtrimin e më tutjeshëm të ligjeve, të cilat i kemi para vetes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë i jep mbështetje parimore Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Për rëndësinë e tij nuk do të flas, sepse foli Kryeministri. Mirëpo, ne u japim mbështetje parimore edhe të gjitha projektligjeve, të cilat janë proceduar për sot në seancën plenare.

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të SLS-së, por mungon.

Në radhë është Grupi Parlamentar “7+”. Në emër të Grupit, deputeti Haxhi Merxha.

ZYLFI MERXHA: I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit të Kosovës,
I nderuar, po ashtu, zoti Kryeministër i Qeverisë së Kosovës dhe ju dy zëvendëskryeministra,
Përshtëndes edhe ministrat dhe zonjat e zotërinjtë deputetë,

Ne, në parim e mbështesim këtë ligj, sepse vërtet është i nevojshëm dhe kurrë më i nevojshëm s’ka qenë për Kosovën, sikur që është sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në vazhdim, ftoj deputetët që të deklarohen për miratimin, në parim, të Projektligjit.

Ju njoftoj se në sallë janë 96 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 87 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

Pas miratimit, në parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që në seancën e radhës t’i paraqet Kuvendit raportin, me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën vijuese:

- Shqyrtimi, në parim, i Projektligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Dispozitat e këtij projektligji janë, po ashtu, të bazuara në nenin 5.1 të aneksit 8 të Propozimit të Presidentit Ahtisari, me qëllim të themelimit të një organizate qeveritare - Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila do të mbikëqyrë dhe ushtrojë kontrollin civil mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, në pajtim me Propozimin gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari dhe dispozitat

e Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kjo ministri do të ketë autoritet ekzekutiv. Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka kontroll dhe administrim të përgjithshëm mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke përfshirë të gjitha fuqitë që bien mbi komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji mbështetet në themelimin e një ministrie, e cila do të funksionojë në pajtim me parimet demokratike, me një staf profesional shërbyes civil, me përvojë dhe pjesëtarë - shërbyes të Forcës së Sigurisë së Kosovës - e ngjashme me ato të shteteve kryesuese anëtare të NATO-s. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Sipas deklaramit të shefave të grupeve, ne mund të vazhdojmë.

Në vazhdim ftoj deputetët që të deklarohen për miratimin, në parim, të Projektligjit.

Ju njoftoj se në sallë janë 93 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Faleminderit! Konstatoj se me 90 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës.

Pas miratimit në parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’ia paraqet Kuvendit raportin, me rekomandime.

Në radhë është pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligji për Forcën e Sigurisë së Republikës së Kosovës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj Kryeministrin e Kosovës që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, Kryetar!

Dispozitat e këtij projektligji janë të bazuara në nenin 5.1 të aneksit 8 të propozimit të Presidentit Ahtisari dhe në nenin 126 të Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ky projektligj rregullon themelimin e Forcës së re të Sigurisë së Kosovës, profesionale dhe multietnike dhe organizimin e brendshëm të saj.

Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë, është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës, të shërbejë si forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës në bashkërendim të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare.

Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë e armatosur sipas standardeve ndërkombëtare. Kjo forcë do të përbëhet nga 2.500 pjesëtarë aktivë dhe 800 pjesëtarë rezervë, e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë, të cilët do t'i mbrojnë qytetarët e Republikës së Kosovës përmes përgjegjësisë së tyre ndaj krizave, largimit të mjeteve shpërthyes dhe mbrojtjes civile.

Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë e dizajnuar dhe e përgatitur për t'i përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë apo organizatave të tjera për zbatimin e ligjit, të cilat funksione do të autorizohen përmes një procesi monitorues sipas standardeve të përcaktuara i cili do të vendoset nga prania ushtarake ndërkombëtare në bashkërendim me përfaqësuesin ndërkombëtar civil. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Në vazhdim kërkoj nga deputetët që të deklaroher për miratimin në parim të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

A ka ndonjë deputet që nuk e ka kartelën me veti? Faleminderit!

Konstatohet se me 95 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Republikës së Kosovës.

Pas miratimit në parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t'i paraqesë Kuvendit raportin, me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Republikës së Kosovës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçin që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, Kryetar!

Dispozitat e këtij projektligji janë të bazuara në nenin 1.4 të aneksit 8 të Propozimit të Presidentit Ahtisari dhe të nenit 127 të Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ky projektligj përcakton: themelimin, përbërjen, kompetencat dhe fushëveprimtarinë e Këshillit të Sigurisë së Kosovës gjatë gjendjes së zakonshme dhe periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, me qëllim të përgjigjes ndaj situatave emergjente, në pajtim me këtë Projektligj.

Pra, ky projektligj mundëson themelimin e një strukture të re të sigurisë, të quajtur Këshilli i Sigurisë së Kosovës, i cili do të funksionojë si një organ këshillues gjatë periudhës së zakonshme dhe si një organ ekzekutiv gjatë situatave të gjendjes së jashtëzakonshme.

Këshilli i Sigurisë së Kosovës rekomandon politika dhe strategji për siguri. Misioni dhe fushëveprimtaria e Këshillit të Sigurisë së Kosovës mbështetet në ofrimin e informatave dhe të vlerësimeve të gjendjes së sigurisë në Kosovë që t'i mundësojë Qeverisë së Republikës së Kosovës marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me çështjen e sigurisë.

Projektligji është plotësisht i harmonizuar me Propozimin gjithëpërfshirës të Ahtisarit dhe me Projektkushtetutën e Kosovës, në pajtim me ligjet në fuqi dhe normat ndërkombëtare në fuqi të qeverisjes së mirë.

Andaj, të nderuar deputetë, kërkoj aprovimin pozitiv të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër! Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Poštovani predsjedniče,
Gospodine premijeru, zamenici premijera,
Ministri i kolege poslanici,

Mi, kao Parlamentarna grupa „7+“ takođe u načelu podržavamo ovaj zakon, ali smo danas dali jednu primedbu preko našeg člana u Ad-hoc komisiji i mi ćemo u vidu amandmana dati takođe jednu primedbu a u načelu ću vas obavestiti o čemu se radi.

Naime, u amandmanu koji predlažemo, citiram izvod iz zakona: “Ukoliko nijedan od stalnih članova sa izvršnim nadležnostima Saveta bezbednosti ne pripada zajednici Srba Kosova“ – „i ostalih zajednica“ - dopunjavamo „premijer će imenovati dodatne članove jednog od Srba ministara Kosova“ a dodajemo „i jednog iz ostalih zajednica ministara Kosova kao dodatne članove Saveta bezbednosti sa izvršnim nadležnostima“.

U prilog ovome ću dodati da u Ahtisarijevom dokumentu, u aneksu 8. u članu 1.2 stoji „da će u skladu sa demokratskim standardima i pravima zajednica i njihovih pripadnika biti“ dakle „članovi i da će Kosovo uspostaviti Kosovski savet za bezbednost“.

Mi çemo preko nadležne komisije dostaviti ovaj amandaman i u načelu, uz ovu primedbu, mi dakle prihvatamo ovaj zakon.

Ne vidimo razloga zašto bi ostale zajednice preko ministara kojeg imaju, jel da, u Vladi Kosova, da ne budu zastupljeni. Ne vidimo razloga zašto, s obzirom da su to integrisane zajednice i da pripadaju ovoj državi, kao ravnopravni građani. Hvala, toliko!

KRYETARI: Fjalën e ka zëvendëskryeministri, zoti Hajredin Kuçi.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra dhe deputetë,

Ne kemi marrë një vërejtje edhe më herët nga Grupi „7+“ lidhur me këtë çështje dhe kemi tentuar t'i japim dy përgjigje:

E para, që Këshillin e Sigurisë Nacionale të mos e bëjmë njëetnik apo përfaqësim etnik, por të tentojmë ta bëjmë për siguri nacionale të vendit. Pra, përfaqësimi duhet të jetë më shumë në kuptimin profesional dhe në kuptimin e vendimmarrjes politike se sa në përfaqësimin etnik.

Dhe, e dyta, në dokumentin e Presidentit Ahtisari është i paraparë një Këshill për Komunitete, ku do të kemi përfaqësim edhe të komuniteteve jo shumicë - joserbe.

Ne, në pajtim edhe me Kryeministrin, jemi pajtuar që komunitetet jo shumicë - joserbe të kenë përfaqësuesin e vet si vëzhgues, por jo domosdo edhe si anëtar të përhershëm.

Mendoj, që kjo është zgjidhje më e mirë, por sido që të jetë, amendamentin do ta shqyrtojmë dhe besoj që Kuvendi do të vendosë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë, amendamenti le t'i dërgohet Komisionit ad-hoc dhe ata le të merren me atë çështje.

Pasi që nuk ka të tjerë për të diskutuar, në vazhdim, ftoj deputetët që të deklarojnë për miratimin, në parim, të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Pyes edhe një herë - a ka deputet që nuk ka kartelë? Faleminderit!

Konstatohet se me 89 vota “për”, 4 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për themelimin e Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Pas miratimit në parim, në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që në seancën e radhës t'ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e pestë e rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim, konform vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008.

Ftoj Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar deputetë,

Me qëllim të rregullimit me ligj të autoritetit dhe të kompetencave të institucioneve të Kosovës, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe me qëllim të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre që jetojnë në Republikën e Kosovës, sot para jush për miratim paraqes Projektligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj parasheh parimet e përgjithshme të përcaktuara në Pakon e Presidentit Ahtisari dhe konsiderohet të jetë ligj organik për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre.

Projektligji është në pajtim të plotë me Konventën kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe dispozitat e Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për gjithë popullin e Kosovës dhe posaçërisht për komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë t'i gëzojnë individualisht apo së bashku me të tjerët të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që janë përcaktuar me obligimet ligjore ndërkombëtare të detyrueshme edhe për Republikën e Kosovës.

Sipas këtij projektligji, komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që lirisht të kultivojnë, të shprehin dhe të zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre, të përdorin gjuhën e tyre, të drejtë ta mbrojnë veten në gjyq në gjuhën e tyre, kanë të drejtën e themelimit të shoqatave kulturore, artistike, shkencore dhe arsimore, kanë të drejtë të festojnë festat e tyre tradicionale dhe fetare në mënyrë të lirë dhe të hapur në pajtim me ligjin, iu

garantohet qasja në informacion pa diskriminim, kanë të drejtë të krijojnë dhe përdorin mediat e tyre duke përfshirë edhe qëllimin e ofrimit të informatave në gjuhën e tyre nëpërmjet gazetave ditore, agjencioneve të lajmeve dhe kanë numër të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

Po ashtu, personat që u përkasin komuniteteve, kanë të drejtë në shkollim publik në të gjitha nivelet në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e zgjedhin. Kanë të drejtë në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre dhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare, kanë të drejtë në lirinë e besimit, të ndërgjegjes dhe të fesë si dhe të drejtat e tjera të përcaktuara në dispozitat e këtij Projektligji.

Në fund, të nderuar deputetë, me qëllim të promovimit dhe garantimit të të gjitha të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës, të cilat rregullohen me këtë Projektligj, ju propozoj miratimin pozitiv të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Në vazhdim ftoj deputetët që të deklarojnë për miratimin, në parim, të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët për përgatitjen për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 89 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Pas miratimit të parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që në seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit raportin, me rekomandime.

Në radhë është pika gjashtë e rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të vitit 2008

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve, më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj ministrin, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

AHMET SHALA: I nderuari zoti Kryetar,
I nderuari zoti Kryeministër,
Zotërinj edhe zonja deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes Projektligjin për menaxhimin e financave publike, i cili paraqet ligjin organik kryesor, pra të menaxhimit të financave dhe përgjegjësitë rreth menaxhimit të fondeve publike.

Ligji i menaxhimit të financave publike aktual është shkruar në vitin 2001 – 2002 dhe ka siguruar bazën ligjore të shëndoshë për menaxhimin e fondeve publike. Megjithatë, gjithkund ka nevojë dhe vend për përmirësime konform edhe proceseve të reja që kanë ndodhur në Kosovë, sidomos pas Pakos së Ahtisarit.

Versioni i ripunuar shënon përmirësim nga versioni origjinal, duke bërë përfshirjen e dispozitave të nevojshme që lidhen me procesin politik të Kosovës dhe forcon autonominë e komunave në procesin e tyre të buxhetimit dhe proceset e tjera fiskale.

Për kontributin e konsiderueshëm për sjelljen e këtij Ligji në këtë nivel që është, për të cilin nuk pretendojmë se është prefekt, por se është një përmirësim i dukshëm karshi kërkesave dhe gjendjes aktuale, më lejoni që para jush t'i falënderoj të gjitha institucionet ndërkombëtare financiare dhe donatorët e tjerë, që na kanë ndihmuar, duke përfshirë këtu sidomos Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Qeverinë Amerikane dhe Zyrën e Komunitetit Ndërkombëtar.

Ndoshta, për juve dhe për të gjithë ne është me rëndësi të theksohen tri përmirësime të dukshme dhe shumë të nevojshme për situatën aktuale në Kosovë, të cilat janë bërë dhe ato janë në amendamentin numër 57 në dispozitat për komuna që harmonizojnë këtë ligj me Ligjin për financat e qeverive lokale dhe sigurojnë autonominë e nevojshme për komunat.

Neni 54, në kuadër të Ministrisë së Financave, parasheh të jetë Njësia për partneritet privat publik, e cila siguron pikën qendrore të këshillave të ekspertëve dhe të asistencës për një fushë që do të jetë e rëndësishme për Kosovën në periudhën e ardhshme, sidomos në angazhimin e sektorit privat, pra, për partneritetin privat publik.

Prandaj, ftoj të gjitha ato institucione që kanë nevojë, pra, komunat, ministrinë e të tjera që ta shfrytëzojnë këtë bazë të fuqishme juridike.

Neni 49 përcakton huazimet dhe i mundëson Qeverisë së Kosovës të hyjë në marrëveshje për huazime dhe të nxjerrë garanci për borxhe, nëse është përfshirë në buxhet dhe aprovohet nga Kuvendi. Këto janë tri elemente themelore që do të doja t'i fokusoj para jush.

Ky ligj ka 15 pjesë dhe 81 nene. Konsideroj se niveli i tij është i mjaftueshëm për t'u siguruar një qëndrueshmëri fiskale, për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të financave publike. Prandaj, kërkoj nga ju që ta mbështetni dhe të votoni këtë ligj kaq të rëndësishëm për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në vazhdim, ftoj deputetët që të deklarohen për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 91 vota “për”, 3 vota “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të vitit 2008.

Pas miratimit në parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t'ia paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi, në parim, i Projektligjit për financat e pushtetit lokal

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj ministrin Ahmet Shala që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

AHMET SHALA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Po ashtu kam nderin që para juve të gjithëve të paraqesë Projektligjin për financimin ose për financat e qeverive lokale, që është po aq i rëndësishëm pothuaj sa edhe Ligji mbi financat publike.

Ky ligj paraqet një gurthemel të rëndësishëm në rrugën drejt decentralizmit të mëtejshëm fiskal në Kosovë. Kompletion institucionalizimin e sistemit financiar komunal përbrenda kornizës ligjore të Kosovës, plotëson dhe implementon kërkesat që lidhen me dispozitat e statusit, mbështet në elementet e mira dhe përmirëson në mënyrë të konsiderueshme mënyrën e financimit të komunave karshi nevojave dhe kërkesave të tyre me qëllim të rritjes së standardeve të qytetarëve të komunës përkatëse.

Ky ligj përcakton një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse, sidomos në autorizimet e shtuara në rregullimin autonom dhe menaxhimin e resurseve financiare, që dalin nga propozimi i Ahtisarit, përcakton resurset vetjake, adekuate në mënyrë që komunat të mund t'i financojnë kompetencat komunale, përfshirë këtu edhe kompetencat vetjake të shtuara, pra të atyre komunave që kanë kompetenca të shtuara karshi statusit të ri të Republikës së Kosovës.

Ky ligj plotëson kërkesat kryesore të dispozitave të statusit, sidomos në këto lëmi:

- merr masa të përshtatshme të barazimit për komunat më të vogla me kapacitete të ulëta për të hyra vetjake;
- alokimin adekuat të resurseve për komunitetet jo shumicë. I keni formulat 89632;
- sigurimin e financimit për kompetencat e shtuara komunale në komunat e caktuara si dhe qasjen në asistencën financiare të jashtme, në veçanti nga Republika e Serbisë.

Po ashtu, në esencë, rregullon edhe këto burime kryesore financiare:

- Grantin e përgjithshëm i përcaktuar 10% i të hyrave të Qeverisë qendrore dhe i alokuar në bazë të formulave që marrin parasysh madhësinë e popullatës, madhësinë e popullatës pakicë dhe madhësinë fizike të komunës;
- Dy grante specifike për edukim dhe shëndetësi, të parashikuara për financim të kostos së shërbimeve standarde minimale dhe të alokuara bazuar në formulën e përcaktuar nga Komisioni i granteve;
- Grantet specifike për financim të kompetencave të shtuara dhe rregullon e cakton përgjegjësitë për kuvendin komunal në fushën e të hyrave vetjake;
- Përcakton barazi të mjaftueshme në mes të pushtetit qendror dhe lokal të komisioni i granteve dhe, mbase më e rëndësishmja e që do të zgjidhet me ligj të veçantë – është se mundëson dhe hapë derën për financim ose për huazim, nëse mund të them, të komunave ndaj institucioneve financiare vendore, duke lënë hapësirë që kjo mënyrë e financimit të komunave, pra huamarrja e komunave, të jetë tepër e kujdesshme dhe të japë mundësi që më vonë të rregullohet me ligj të veçantë.

Konsideroj, që dikur kah fundi i vitit, do ta rregullojmë huazimin jo vetëm për komuna, por edhe për Kosovë, me ligj të veçantë, por komunave iu jep mundësi, nëse ato janë mirë të menaxhuara, për të marrë hua nga bankat dhe institucionet që janë të licencuara në Kosovë.

Konsideroj se ky ligj e ka arritur fazën e pjekurisë dhe është i elaboruar në mënyrë të detajuar.

Ftoj deputetët e nderuar dhe ju, zoti kryetar, që ta përkrahni dhe aprovoni këtë Ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër për sqarime të mjaftueshme.

Në vazhdim, ftoj deputetët që të deklarojnë për miratim, në parim, të këtij Projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, 4 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për financat e pushtetit lokal.

Pas miratimit, në parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t’i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Aviacionin Civil të Kosovës**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj ministrin Fatmir Limaj që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

FATMIR LIMAJ: I nderuar Kryetar,
Zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Si angazhim i përmbushjes së obligimeve që dalin nga Pakoja e Ahtisarit, edhe Ministria jonë ka marrë të gjitha përgjegjësitë në përgatitjen e atyre ligjeve që neve na takojnë nga kjo pako.

Në këtë kontekst, para jush keni Draftligjin për Aviacionin Civil të Kosovës.

Para se të parashtroj para jush konceptin, përmbajtjen dhe strukturën e draftligjit, ju bëj me dije se kjo fushë ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/18 dhe me Rregulloren 2004/5, e cila kornizë ligjore nuk i ka rregulluar shumë çështje dhe ka pasur mangësi në zbatimin e saj dhe nuk ka qenë e përshtatur mjaftueshëm me standardet ndërkombëtare evropiane të aviacionit civil.

Deri më tash, sipas kësaj Rregulloreje, kompetencat në fushën e aviacionit civil kanë qenë nën autoritetin e UNMIK-ut, kurse me Draftligjin në fjalë, këto kompetenca plotësisht janë të transferuara në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Në draftimin e këtij ligji janë angazhuar ekspertë të Qeverisë së Kosovës, të ministrisë përkatëse e po ashtu edhe ekspertë ndërkombëtarë, të cilët i falënderojmë për angazhimin e tyre, që në muajt e fundit, me angazhimin intensiv, kanë kryer një punë të madhe profesionale dhe me vlerë të madhe në draftimin e këtij ligji i cili e rregullon fushën e aviacionit civil të Kosovës.

Në këtë draftligj kemi përfshirë komentet, sugjerimet dhe propozimet e të gjitha palëve të interesuara. Dhe, po ashtu, përsa i takon përmbajtjes, dua të nënvizoj se ky draftligj është në harmoni me sistemin juridik, që do të thotë se nuk bie ndesh me ligjet apo rregulloret në fuqi, por është i harmonizuar me sistemin tonë kushtetues ligjor dhe institucional të Republikës sonë.

Koncepti i këtij projektligji është i bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil.

Të nderuar deputetë,

Projektligji ka akceptuar në përmbajtjen e tij parimet ndërkombëtare të Konventës së Çikagos mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar të vitit 1944, dispozitat e Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit Civil - marrëveshje e cila në Kosovë është bërë e detyrueshme që nga 30 nëntori i vitit 2006 nga ana e UNMIK-ut.

Po ashtu ka akceptuar në tërësi standardet e kërkuara nga Bashkimi Evropian në këtë fushë, si qëllim dhe objektiv, të parashtruara në të gjitha nivelet e institucionit shtetëror të Republikës sonë.

Përmbajtja, struktura dhe koncepti i draftligjit, në mënyrë thelbësore, rregullojnë të gjitha aktivitetet e aviacionit civil që do të zhvillohen në Republikën tonë.

Draftligji në brendinë e tij përfshin të gjitha çështjet që nevojiten për rregullimin e aktiviteteve në fushën e aviacionit civil.

Në përmbajtje të draftligjit janë përshkruar, në mënyrë të qartë, përgjegjësitë e ndara dhe të përbashkëta të autoriteteve shtetërore të Republikës përsa i përket zbatimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të këtij ligji në këtë fushë, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Mbi të gjitha, me këtë ligj rregullohet përfundimisht se: Kosova ka sovranitet të plotë, ekskluziv dhe të paprekshëm në hapësirën e saj ajrore mbi territorin e saj dhe ka autoritet ekskluziv për organizimin dhe rregullimin e aktiviteteve të aviacionit civil në territorin dhe hapësirën ajrore të vendit tonë.

Mendoj që ky koncept apo ky draftligj ka ndarë përgjegjësitë e autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës përsa i takon rregullimit ekonomik e po ashtu edhe të sigurisë.

Draftligji ka definuar autoritet e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, përgjegjësitë, detyrat, operimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe dispozitat ndëshkimore përfshirë këtu edhe shkeljet administrative dhe veprat penale - me specifika të veçanta që mund të shfaqen në aktivitetin e aviacionit civil.

Autoritetet kryesore përgjegjëse për fushën e aviacionit civil në vendin tonë, janë:

- Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoritet kombëtar i pavarur, i cili, do të mbikëqyrret nga një bord dhe do të menaxhohet nga drejtori i përgjithshëm e po ashtu nga Komisioni për hetimin e aksidenteve dhe të incidenteve aeronautike.

Autoriteti i Aviacionit Civil në këtë draftligj definohet si autoritet kryesor kombëtar i rregullimit të aspektit të sigurisë teknike, përfshirë këtu edhe rregullimin e sigurisë e po ashtu edhe të ekonomisë të aeroporteve, certifikimin e personave, të operatorëve ajror të fluturakeve dhe të personelit ajror.

Autoriteti i Aviacionit Civil zbaton Ligjin mbi Aviacionin Civil si dhe politikat e miratuara nga Ministria dhe Qeveria në fushën e aviacionit civil.

Po ashtu ky rregullator ka buxhetin e tij, i cili përbëhet nga taksat, të cilat do të përfshihen dhe aplikohen në fushat e aviacionit civil, tarifat e ndryshme dhe donacionet që i dedikohen zhvillimit të aviacionit civil.

Gjithashtu, drafti në përmbajtje parasheh procedurat që përshkruajnë kushtet, shkeljet e sanksionet administrative dhe veprat penale për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji. Për këtë, edhe është paraparë krijimi i Komisionit për hetimin e aksidenteve dhe të incidenteve aeronautike dhe kjo zyrë do të jetë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës, i cili do të jetë përgjegjës për hetimin e aksidenteve dhe të incidenteve aeronautike. Buxheti i saj dhe personeli rregullohen në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Draftligji rregullon dhe krijon mundësi të mjaftueshme për zhvillimin, menaxhimin, operimin, mbikëqyrjen e fushës së aviacionit nga institucionet e Republikës sonë.

Ky draftligj obligon Republikën e Kosovës që të respektojë dhe hapë rrugë për aderim në mekanizmat ndërkombëtar evropian në fushën e aviacionit civil.

Duke e përfunduar, të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që ky Projektligj të aprovohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tani ftoj deputetët që të deklarojnë për miratimin, në parim, të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 96 vota “për”, 2 vota “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Aviacionin Civil të Republikës së Kosovës.

Pas miratimit në parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’i paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim, konform vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj Ministren Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

NEKIBE KELMENDI: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuari zoti Kryeministër,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Drejtësisë të prezantoj para jush Projektligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Qëllim i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për themelimin e Prokurorisë Speciale, si institucion i pavarur i Republikës së Kosovës, me prani të përkohshme të prokurorëve të EULEX-it, i cili do ta zëvendësojë Prokurorin e gjertanishëm special për të siguruar hetimin dhe ndjekjen penale për krimet e luftës, krimet e organizuara, terrorizmin, krimet ekonomike e financiare dhe krimet e tjera serioze.

Nevoja për nxjerrjen e Ligjit për Prokurorinë Speciale është përsheptimi i procedurave për ndjekjen dhe hetimin e veprave penale të numëruara me sipër dhe shtimin e efikasitetit të sistemit prokurorial të Kosovës në tërësi.

Me këtë ligj nuk cenohet sistemi unik prokurorial i Republikës së Kosovës, që do të thotë se ky sistem mbetet unik dhe nuk nënkupton krijimin e një sistemi paralel prokurorial.

Ky ligj ka gjithsej 5 kapituj, me 16 nene.

Kapitulli i parë u referohet dispozitave të përgjithshme dhe përkufizimit të shkurtesave të përdorura në këtë Projektligj.

Kapitulli i dytë përcakton kompetencat e veçanta të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, konform ligjeve në fuqi, rregullon delegimin e lëndëve nga Prokuroria Speciale kur kompetencat duhet t'i ushtrojë Prokuroria e Kosovës dhe kompetencat e veçanta për lëndët e deleguara nga Gjykata Ndërkombëtare.

Kapitulli i tretë përcakton kompetencat plotësuese për Prokurorinë Speciale, procedurat për zgjidhjen e kundërshtimit lidhur me propozimin për të marrë përgjegjësi për lëndët nga ana e Prokurorisë Speciale dhe procedurat e rishqyrtimit.

Kapitulli i katërt rregullon kompetencën për lëndët e hetuara ose të ndjekura penalisht nga Prokurori Special dhe delegimin e përgjithshëm të lëndëve.

Kapitulli i pestë përmban dispozitat përfundimtare dhe kalimtare, me të cilat përcaktohet numri i prokurorëve të EULEX-it, që do të angazhohen në Prokurorinë Speciale dhe kompetencat e tyre.

Ministria e Drejtësisë konsideron se ky ligj duhet të radhitet në pakon e ligjeve të zotit Ahtisari, andaj i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta miratojë sipas procedurave të parapara me Vendimin e këtij Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zonja ministre!

Në vazhdim ftoj deputetët që të deklarojnë për miratimin, në parim, të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, 4 vota “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Pas miratimit në parim, në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që në seancën e radhës t’i paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e dhjetë dhe e fundit e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Republikën e Kosovës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 11 mars 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008.

Ftoj ministren Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni që në radhë të prezantoj para jush, deputetë të nderuar, Projektligjin mbi kompetencat për zgjidhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për Misionin e EULEX-it në Kosovë dhe ofrimin e ndihmës për forcimin e sistemit gjyqësor dhe të atij prokurorial në Kosovë, të cilat institucione do të sigurohen nga pavarësia dhe çfarëdo ndikimi mbi to, që do të thotë se këto institucione do ta sigurojnë në tërësi pavarësinë e tyre.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji, sikur që jeni në dijeni, buron nga propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, i miratuar me një Rezolutë të këtij vendi dhe ajo përcakton përfshirjen e një numri të caktuar gjyqtarësh dhe prokurorësh të EULEX-it, të cilët do të bashkëpunojnë ngusht me gjyqtarë dhe prokurorë vendorë, por që me propozimin e përmendur kanë kompetenca për të hetuar dhe gjykuar veprat penale dhe çështjet civile, të përcaktuara me këtë ligj dhe të bazuara në aneksin 9 e 10 të Propozimit të zotit Ahtisari.

Me këtë projektligj do të shkarkohen gjykatat kosovare nga stërngarkimi me lëndë dhe do të shtohet efikasiteti i tyre në zgjidhjen e çështjeve të parashtruara brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç është paraparë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me këtë ligj, gjithashtu, sikur edhe me ligjin e mëparshëm, nuk cenohet sistemi unik gjyqësor i Republikës së Kosovës, që do të thotë se ky sistem mbetet unik dhe nuk nënkupton krijimin e një sistemi paralel gjyqësor në Kosovë.

Ky ligj ka gjithsej 4 kapituj, përkatësisht 19 nene.

Kapitulli i parë u referohet dispozitave të përgjithshme dhe përkufizimit të shkurtesave të përdorura në këtë Projektligj.

Kapitulli i dytë përcakton kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në çështjet penale e civile, kompetencat e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it dhe të Kryeprokurorit të Kosovës në procedurat për përjashtimin, konform ligjeve në fuqi.

Kapitulli i tretë përcakton kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it, mënyrën e ushtrimit të këtyre kompetencave në Prokurori, përgjegjësitë e përbashkëta të ekipeve të përziera dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe delegimin e kompetencave territoriale të gjykatave e të prokurorive në çështjet penale dhe ato civile.

Dhe, kapitulli i katërt, përmban dispozitat përfundimtare e kalimtare.

Ministria e Drejtësisë, konsideron se ky ligj, gjithashtu duhet të radhitet në të ashtuquajturën “Pakon e ligjeve” të zotit Ahtisari, andaj i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta miratojë sipas procedurave të parapara për miratimin e ligjeve që dalin nga kjo pako. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre!

Ftoj deputetët që të deklarojnë për miratimin, në parim, të këtij Projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, 6 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Republikën e Kosovës.

Pas këtij miratimi, në bazë të Vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që në seancën e radhës t’i paraqet Kuvendit raport me rekomandime.

Para se ta mbylлим seancën e sotme, dëshiroj t’ju falënderoj për kontributin tuaj, meqë të gjitha ligjet u miratuan me më shumë se dy të tretat e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Seanca vazhdon punën nesër dhe është caktuar për në orën 14,00.

Pra, mirupafshim nesër!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës